

KONTRATË SHITJE-BLERJESH KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 11.05.2021 (dymijë e njëzet e një), në mjediset e Shoqërisë "G&P", shpk, me adresë në Tiranë, Kompleksi "Secret Garden", Mullet, Petrelë, përpilohet kjo kontratë Shitje-Blerje Kuotash, midis palëve, personalisht :

SHITËSI: z. **Shefki Karamuç**a, i biri i Ramizit, i datelindjes 17/01/1968, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë me adresë kompleksi rezidencial "Secret Garden", Mullet-Njësia Administrative Petrelë, Tiranë, i identifikuar me ID me numër Nr. **033050851** dhe Nr. Personal **G80117110A**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë "G&P" shpk,

(që këtu e më poshtë do të quhet "SHITËSI")

dhe,

BLERËS: Z. **Safet KARAMUCA** atësia Ramiz, amësi Laje, lindur në Gurakuq Librazhd, dhe banues në Tiranë, Shqipëri (ALB), me adresë, në Mullet, Njësia Administrative Petrelë, Tiranë Kompleksi Rezidencial "Secret Garden", Njësia Bashkiake Nr.13, Tiranë, i datelindjes 05.03.1966, me gjendje civile "i martuar", shtetas shqipëtar, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftim ID Nr. **036872201** dhe Nr. Personal **G60305160C**,

BLERËS: Z.**Bashkim Karamuç**a, atësia Ramiz dhe amësia Laje, shtetas shqipëtar, lindur në Tiranë, Shqipëri (ALB) dhe banues ne Vorë, me adresë Rr" Vorë", Nd. 151, Vorë 1031, i datelindjes 24/06/1969, me gjendja çivile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim numër Nr. **031580870** dhe Nr. Personal **G90624115W**.

(këtu e më poshtë do të quhet "BLERËSIT")

Pasi konstatova statusin juridik të palëve, të tre madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë ata kërkuan dhe ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate Shitjeje Kuotash duke u mbështetur në parashikimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" sipas kushteve që vijojnë më poshtë:

Ekzistojnë këto kushte paraprake

1. Rezulton se shoqëria "G&P" sh.p.k, është person juridik shqiptar rregjistruar në Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit (QKR) më datë 17.11.2005 dhe pajisur me numër identifikimi NUIS K71528003O, me kapital themeltar prej **402.493.925** Ortak i Vetëm i Shoqërisë "G&P" sh.p. është:
 - **Shefki Karamuçça**, i cili zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit të Shoqërisë me vlerë **402.493.925** lekë që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë
2. Shoqëria ka si objekt veprimtarie :

Tregtim me shumicë e pakicë të mallrave industriale, bujqësore, materiale ndërtimi, pjesë këmbimi etj. Shoqëria do të kryejë eksport dhe import materiale ndërtimi, shitje, përpunimin dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me materialet e ndërtimit. Mbledhje, depozitimi, përpunimi dhe tregtimi i skrapit dhe materialeve të tjera që lidhen me skrapin. Ndërtime civile, turistike industriale dhe natyrave të tjera, ndërtim objektesh banimi dhe shërbimesh, ndërtim objektesh publike e jo-publike, ndërtim objektesh turistike, ura, rruge, hekurudha. Montim konstruksionesh metalike, studim, projektim, konsulence, sipermarrje. Prodhimin me fonde private/publike të materialeve, prodhimin e inerteve, asfalto beton. Në fushën e shërbimeve: Konsulencë në fusha të ndryshme, monitorim, menaxhimet dhe studimet e te gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marreveshje, veprimtari ndermjetesimi. Në fushën e turizmit: Ndërtim objektesh turistike publike dhe private, menaxhim objekte turistike. Transport të ndryshëm me makineri dhe pajisje transportuese për nevojat e transportin e materialeve dhe njerezve. Shfrytëzim pyjor dhe parcelave pyjore, nderhyrje ne pyll dhe trajtime ne silvikulture, vjelja e materialeve drusore, trajtim i pyjeve, mbrojtja, permiresimi, rehabilitimi i kushteve te mjedisit pyjor. Blerje dhe shitje pasuri te paluajtshme, investim në pasuri të paluajtshme, dhe kryerja e veprime të tjera tregtare.

3. Në datë 10.05.2021, ora 14.00, është mbajtur mbledhja e Asamblesë të Shoqërisë "G&P" sh.p.k, në të cilën është vendosur shitja e 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ose 201.246.962 (ALL) prej ortakut të vetëm z. Shefki Karamuça në favor të ortakut tjetër z. Safet Karamuça dhe Bashkim Karamuca.

Neni 1 Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është shitja e 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, të zotëruara nga ortaku i vetëm Z.Shefki Karamuça në favor të ortakut z. Safet Karamuça dhe z. Bashkim Karamuca.

Neni 2 Çmimi i shitjes

Shitësi z. Shefki Karamuça është dakord dhe me vullnet të lirë i shet blerësit:

- z. Safet Karamuça, në total 1 kuotë që është e barabartë me vlerën e 100.623.481,25 Lekë dhe që përfaqëson 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- z. Bashkim Karamuça, 1 kuotë që është e barabartë me vlerën e 100.623.481,25 Lekë dhe që përfaqëson 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pas kësaj shitje z. Shefki Karamuca do të zotërojë 1 kuotë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë në vlerën 201.246.962,5

Palët deklarojnë se pagimi i cmimit të shitjes është kryer plotësisht nga blerësi, sot në datën e hartimit të kësaj Kontratë.

Neni 3 Kalimi i titullit të pronësisë

Kalimi i titullit të pronësisë dhe fitimi i pronësisë bëhet nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e rregjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Një kopje e kësaj kontrate shitjeje do të depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, (QKB) në mënyrë që të bëhet kalimi i menjëhershëm i kuotave në pronësi të blerësit.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitësit

Shitësi mori përsipër, të njoftojë, garantojë dhe sigurojë Blerësit se deri në momentin e lidhjes dhe të nënshkrimit të Kontratës së mësipërme këto kuota:

- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
- Nuk janë të bllokuara për llogari të të tretëve;
- Shitësi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë të kenë pretendime në lidhje me këto kuota;
- Dokumentacioni i bashkëngjitur kësaj Kontrate, është origjinal, ligjor dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo i fallsifikuar;
- Nuk ka asnjë kontratë të lidhur më parë e cila të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto aksione;
- Shitësi nuk ka detyrime të papaguara në favor të të tretëve .

Shitësi është i detyruar të paguajë detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga blerësi. Shpenzimet e tjera bëhen nga palët sipas parashikimeve të Kodit Civil.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësit do paguajë çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zotëron në shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve dhe shtetit.

Blerësit kanë të drejtë që të sillet si pronarë të ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Blerësit angazhohen të mbajnë në emrin e vet kuotat që do të përfitojë nga kjo kontratë shitje kuotash.

Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë, të palëve.

Neni 6 Zgjidhja e Kontratës

Palët nuk mund ta zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në Kontratë në mënyrë të njëanshme. Për çdo problem që mund të lindë, apo ndryshim i domosdoshëm i kontratës i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëri tjetrin në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakord mund të realizojnë ndryshime në kontratë.

Neni 7 Interpretimi i Kontratës në tërësi

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

Neni 8 Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo Kontratë shitje, me objekt Shitje kuotash, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” .

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata e Shitjes së Kuotave, u lexua me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqënëse ajo

shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht, duke vënë emrin e mbiemrin.

SHITËSI

Shefki KARAMUÇA

Shefki Karamuç



BLERËSI

Safet KARAMUÇA

Safet Karamuç

Bashkim KARAMUÇA

Bashkim Karamuç